

VENDIM
Nr.624, datë 21.12.1999

**PËR PËRBALLIMIN E SHPENZIMEVE TË PALËS SHQIPTARE, PJESËMARRËSE NË
FORCËN SHUMËKOMBËSHE TË EUROPËS JUGLINDORE DHE TË DREJTAT E
USHTARAKËVE AKTIVË, PJESËMARRËS NË KËTË FORCË.**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 9 të ligjit nr.7496, datë 3.7.1991, "Për statusin e ushtarakut të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë" dhe të nenit 12 të ligjit nr.8544, datë 4.11.1999 për ratifikimin e Marrëveshjes dhe Protokollit Shtesë "Për krijimin e Forcës Shumëkombëshe të Europës Juglindore", me propozimin e Ministrisë së Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave,

VENDOSI:

I. Mbi shpenzimet financiare të palës shqiptare për forcën shumëkombëshe të Europës Juglindore

1. Ministria e Mbrojtjes të përballojë shpenzimet e palës shqiptare, pjesëmarrëse në strukturën e Forcës Shumëkombëshe të Europës Juglindore për:

a)shpenzime kombëtare direkte, të përdorura për mbështetjen e forcave tona pjesëmarrëse në këtë forcë;

b)shpenzime administrative për buxhetin e përbashkët të Shtabit të Brigadës për veprime, operacionale e mirëmbajtje.

II.Të drejtat e ushtarakëve

1.Ushtaraku aktiv i Forcave të Armatosura në Republikën e Shqipërisë, i transferuar e caktuar në detyrë pranë komandës së Forcës Shumëkombëshe të Europës Juglindore, me vendndodhje në Plovdiv, Bullgari, përveç pagës (pagë klase, shtesë vjetërsie dhe shpërblim për gradën) të funksionit organik, që mban aktualisht, në momentin e transferimit dhe emërimit në këtë komandë, merr alokacion.

2.Alokacioni fillon të paguhet ditën e arritjes së ushtarakut në zyrat e kësaj komande ndërkombëtare dhe ndërpritet ditën e largimit, pas mbarimit të misionit.

3.Ushtaraku aktiv, kur shkon për herë të parë në zyrat e kësaj Komande, merr si paradhënie, në valutë, alokacionin për 15 ditë, të cilin e shlyen brenda 6 muajve nga dita e fillimit të detyrës. Nëse transferohet në atdhe, para mbarimit të këtij afati, kundërvlerën e paradhënies së mbetur, e shlyen në lekë, sipas kursit të valutave, brend 6 muajve pas kthimit në atdhe.

4.Kur ushtaraku aktiv dërgohet me shërbim jashtë venddislokimit të kësaj komande ose kur vjen në atdhe, por në shtetin ku kryen detyrën ka lënë bashkëshorten dhe fëmijët, këta të fundit marrin 100 për qind të alokacionit.

5.Kur ushtaraku aktiv shtrohet në institucionet shëndetësore të shtetit ku ndodhet komanda ndërkombëtare ose në ndonjë shtet tjetër, merr 95 për qind të alokacionit.

6. ushtaraku aktiv gëzon të drejtën e pushimeve javore, pushimeve në ditët e festave zyrtare dhe pushtimin vjetor të paguar, për kohën që është me detyrë jashtë shtetit, sipas dispozitave ligjore në Republikën e Shqipërisë.

Shteti nuk merr përsipër shpenzimet për ushtarakun, kur ai kthehet në atdhe për të bërë lejen e zakonshme.

Me miratim të Ministrit të Mbrojtjes, për raste të veçanta (vetëm për fatkeqësi) paguhen nga shteti vetëm shpenzimet e udhëtimit (për ardhjen në atdhe dhe kthimin në vendin e huaj) për ushtarakun e bashkëshorten.

7. Punësimi i bashkëshorts të ushtarakut aktiv, bëhet vetëm me miratim të Ministrit të Mbrojtjes. Në këto raste, alokacionit i bëhet zbritje 30 për qind.

8.Ushtaraku aktiv, me qëllim që të dorëzojë detyrën në rregull, merr një alokacion deri në 15 ditë, kur është ngarkuar me përgjegjësi financiare e materiale dhe deri në 5 ditë për ushtarakët e tjerë.

9.Ministria e Mbrojtjes për këta ushtarakë aktivë, bashkëshortet e tyre, si dhe fëmijët parashkollorë, bën sigurimin shëndetësor dhe sigurime të tjera të detyrueshme, sipas legjislacionit të

shtetit përkatës.

Ushtaraku aktiv dhe bashkëshortja e tij, si dhe fëmijët parashkollorë kanë të drejtë, që për raste urgjencash të mjekohen në vendin ku kryejnë detyrën, me miratim të eprorit më të lartë, kur për një gjë të tillë nuk është parashikuar sigurim shëndetësor. Në këtë rast shpenzimet përballohen nga shteti, ndërsa për rastet e tjera, shpenzimet përballohen nga vetë ushtaraku.

10.Shkallëzim në përqindje u funksioneve të këtyre ushtarakëve, në raport me nivelin bazë është:

-N/oficer kariere -170%

-Shef i xhenios së brigadës (oficer aktiv)-190%

-Zv/shef i Shtabit të Brigadës (oficer aktiv) -200%

11.Masa e alokacionit për këtë shtet, Bullgarinë, për nivelin bazë (100%) caktohet nga Ministria e Financave dhe Ministria e Mbrojtjes, duke u mbështetur në koston e jetesës së këtij shteti.

Në bazë të alokacionit për nivelin bazë dhe shkallëzimeve të mësipërme, Ministria e Mbrojtjes cakton alokacionin e ushtarakut aktiv.

12.Ministria e Mbrojtjes përballon shpenzimet për qira, energji elektrike, ujë, ngrohje e gaz të apartamentit të banimit të këtij ushtaraku.

13.Ushtaraku aktiv ka të drejtë të marrë shpenzime udhëtimi, akomodimi dhe dietë në valutë të huaj, sipas legjislacionit në fuqi, kur emërohet në detyrë, thirret në atdhe ose dërgohet me shërbim në një shtet tjetër nga titullari, kthehet në atdhe me përfundimin e misionit, si dhe dërgohet me shërbim për nevoja pune nga komandanti i Brigadës Shumëkombëshe të Europës Juglindore. Për rastin e fundit Ministria e Mbrojtjes nxjerr udhëzim të veçantë.

14.Për rastet e parashikuara në pikën 13, zv/shtet i Shtabit të Brigadës merr dietën e kategorisë së dytë dhe ushtarakët e tjerë marrin dietën e kategorisë së tretë. Kur ushtaraku shoqërohet nga bashkëshortja, kjo e fundit merr dietën e kategorisë së tretë.

15.Në rast se ndonjë nga shtet pjesëmarrës në këtë Forcë, me dëshirën e vet ofron shpërblim për ushtarakët tanë, pjesëmarrës në këtë forcë dhe ky shpërblim nuk sjell detyrime për shtetin tonë, ushtarakut i lind e drejta ta përfitojë këtë shpërblim.

III.Efektet financiare nga zbatimi i këtij vendimi për vitin 1999, të përballohen nga fondet e miratuara në buxhetin e Ministrisë së Mbrojtjes për këtë vit, në shumën 4 170 mijë lekë.

IV.Ngarkohen Ministria e Mbrojtjes dhe Ministria e Financave të nxjerrë udhëzimin përkatës për zbatimin e këtij vendimi dhe përfshirjen e efekteve financiare për vitet në vazhdim.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Ilir Meta